

VENDIM
Nr.637, datë 21.5.2008

**PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE TË TRANSPORTIT QYTETAS TË UDHËTARËVE, TË
MIRATUARA ME VENDIMIN NR.146, DATË 26.2.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 4 e 5 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “a” e pikës 1 të vendimit nr.146, datë 26.2.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Tarifat e transportit qytetas të udhëtarëve, me autobus, në linjat me largësi deri në 9 km, janë:

- | | |
|---|--------------------------------|
| i) Për një udhëtim vajtje ose kthim | 30 (tridhjetë) lekë; |
| ii) Për biletë pajtimi mujor, për një linjë | 900 (nëntëqind) lekë; |
| iii) Për biletë pajtimi mujor, të përgjithshëm | 1200 (një mijë e dyqind) lekë; |
| iv) Për biletë pajtimi mujor, të përgjithshëm,
për nxënësit dhe studentët, për të gjitha linjat,
brenda qytetit | 600 (gjashtëqind) lekë.”. |
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha